



Administrata Tatimore e Kosovës
Poreska Administracija Kosova
Tax Administration of Kosovo

UDHËZUES PËR PËRDORIMIN E TË DHËNAVE TË HAPURA

Parathënie

Ky udhëzues është zhvilluar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), me mbështetjen e Programit të USAID për Qeverisje Ekonomike, për të gjithë përdoruesit e mundshëm të të dhënave të hapura të ATK (Open Data).

Në këtë udhëzues sqarohen në hollësi burimet e të dhënave, struktura e të dhënave, udhëzimet për interpretimin dhe përdorimin e tyre.

Çfarë janë të Dhënat e Hapura të ATK (Open Data)?

Të dhënat e hapura janë të dhëna administrative të ATK që janë publikuar në faqen e internetit të ATK-së (për më shumë referohuni tek vegëza: <https://www.atk-ks.org/open-data/>).

Të dhënat janë paraqitur në format të standardizuar, për të lehtësuar përdorimin, përpunimin, shpërndarjen dhe rishpërndarjen e tyre të lirshme nga të gjitha palët e interesit.

ATK është e përkushtuar për transparencën dhe hapjen e të dhënave të saj për publikun, për të promovuar përdorimin e tyre të gjerë.

Shënim: Të dhënat që publikohen në ueb-faqen e ATK-së shërbejnë vetëm për qëllime statistikore dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Çdo mospërputhje e mundshme ndërmjet këtyre të dhënave dhe të dhënave të tjera fiskale të publikuara nga organizatat e tjera qeveritare apo joqeveritare i atribuohet natyrës dinamike të të dhënave

Një numër i madh i variablave të përdorura përfaqësojnë indikatorë dinamik që mund të ndikohen nga legjislacioni tatimor në fuqi, i cili është i përmbledhur si më poshtë. Për shembull, variabli mbi qarkullimin mund të ndryshojë pas një korigjimi të bërë nga vetë tatimpaguesi apo nga ATK për një deklaram që i përket një periudhe të mëhershme, e që do të ndryshojë vlerën e qarkullimit në atë periudhë të mëhershme. Si pasojë e këtyre dinamikave, mund të ndodh që të dhënat për periudha të mëhershme të ndryshojnë sipas Ligjit mbi Administrimin e Procedurave Tatimore. Për vitet e mëparshme, të dhënat do të mbahen si të dhëna historike dhe nuk do të përditësohen pas përfundimit të vitit përkatës.

Definicionet në këtë dokument kanë për qëllim sqarimin e variablave në datasetet e publikuara në 'Open Data' dhe nuk mund të përdoren për qëllime të tjera. Në rast të konfliktit mes një definicioni në një akt ligjor ose nënligjor dhe një definicioni në këtë dokument, atëherë definicioni në aktet ligjore ose nënligjore përkatëse mbizotëron.

Citimi i rekomanduar: 'Burimi: Të dhënat e hapura - Administrata Tatimore e Kosovës'.

Variablat e përdorura në të dhënat e hapura të ATK

Variabli	Përkufizimi	Shënime Shtesë
Viti	Viti fiskal (periudhë kohore një-vjeçare që përdoret nga Qeveria dhe tatimpaguesit për t'i raportuar të ardhurat dhe shpenzimet e tyre), në kontekstin e dataseteve (grupeve të të dhënave), për çdo periudhë nga viti 2018 deri në vitin aktual.	Në Republikën e Kosovës, viti fiskal është i njëjtë me atë kalendarik, pra fillon më 1 janar dhe përfundon më 31 dhjetor të çdo viti. Çdo vit është i paraqitur si një dataset i veçantë dhe i përmban të dhënat për vitin fiskal përkatës.
Muaji	Muajt kalendarik nga janari deri në dhjetor, në format numerik (1, 2, 3, ..., 12).	Muajt janë të përsëritshëm në kolonat e dataseteve derisa të jenë të mbuluara të gjitha informacionet horizontalisht për variablat tjera brenda një dataseti. Pasi të plotësohen të gjitha informacionet për një muaj, vazhdohet me muajin e radhës. Në datasetet e një viti aktual, mund të përfshihet edhe muaji dhjetor para mbylljes së vitit fiskal, në rastet kur tatimpaguesi i ka përfunduar pagesat e kësteve në formë të paradhënies, të tatimit në të ardhurat e korporatave apo të tatimit në të ardhurat personale.
Sektori primar	Sektori përcaktohet sipas nomenklaturës së veprimtarive ekonomike (NACE Rev. 2) ¹ , që është klasifikimi i aktiviteteve ekonomike sipas Sistemit Statistikor Evropian.	Në fund të këtij dokumenti do t'i gjeni të gjitha kodet NACE të cilat janë përfshirë në datasete.
Komuna	Të gjitha komunat e Republikës së Kosovës.	.
Meshkuj	Numri i individëve të deklaruar si meshkuj në deklaratën përkatëse.	.
Femra	Numri i individëve të deklaruar si femra në deklaratën përkatëse.	.
Të paidentifikuar	Përdoret kur tatimpaguesi nuk e ka plotësuar informatën mbi gjininë në dokumentacionin përkatës.	.
Statusi i regjistrimit	Ky variabël e tregon statusin juridik të një subjekti, sipas statusit të regjistrimit të biznesit në bazë të Ligjit për	.

¹ <https://arbk.rks-gov.net/desk/inc/media/FA0E6C9D-2422-481E-8047-A2AFB4B9124C.pdf>

	Shoqëritë Tregtare ose ligjeve tjera përkatëse në fuqi. ²	
Numri i tatimpaguesve	Ky variabël e paraqet numrin total të tatimpaguesve që i kanë paguar dhe deklaruar tatimet e rregullta në bazë të ligjeve tatimore në fuqi në periudhën përkatëse.	Një tatimpagues llogaritet në çdo muaj të datasetit nëse ai/ajo: <ul style="list-style-type: none"> - E ka deklaruar qarkullimin. - Ka deklaruar dhe paguar tatime në bazë të legjislacionit për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin në të Ardhurat Personale dhe Tatimin në të Ardhurat e Korporatave. - I ka deklaruar punonjësit sipas periudhave përkatëse. - I ka deklaruar investimet në librin e blerjeve të TVSH-së.
Qarkullimi	Shuma totale e shitjeve të mallrave dhe shërbimeve nga tatimpaguesit gjatë periudhës së raportimit.	Tatimpaguesi numërohet në dataset në secilin muaj në të cilin ai/ajo ka raportuar qarkullim (pra, nëse tatimpaguesi ka raportuar qarkullim në janar, mars, korrik dhe shtator, ai/ajo do të jetë i/e numëruar 4 herë në atë dataset).
Pagesat	Shuma totale e tatimeve të paguara nga tatimpaguesit, të ndara sipas llojeve të ndryshme të formularëve të deklarimit, në përputhje me legjislacionin tatimor që është në fuqi gjatë periudhës përkatëse. Kjo e përfshin Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin në të Ardhura Personale dhe Tatimin në të Ardhurat e Korporatave.	Tatimpaguesi numërohet në dataset në secilin muaj në të cilin ai/ajo i ka raportuar pagesat (pra, nëse tatimpaguesi i ka raportuar pagesat në janar, mars, korrik dhe shtator, ai/ajo do të jetë i/e numëruar 4 herë në atë dataset).
Deklarimi	Procesi i deklarimit tatimor është një procedurë administrative përmes së cilës tatimpaguesit vetë-deklorojnë në ATK-në të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet e tjera tatimore që i kanë gjatë një periudhe të caktuar fiskale.	.
Lloji i formularit të deklarimit	Formulari i deklarimit është një dokument zyrtar që përdoret për t'i deklaruar të ardhurat, shpenzimet si dhe obligimet tatimore ndaj ATK-së.	Variabli përfshin të dhëna për llojet e ndryshme të tatimeve dhe kontributeve të deklaruar si: <ul style="list-style-type: none"> - Interesi dhe dividendët - Qiraja e mbajtur në burim - Këstet tremujore për biznese të vogla individuale - Këstet tremujore për korporata të vogla - Kontributet dhe pensionet, përfshirë pensionet individuale - Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)

² <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=16426>

		<ul style="list-style-type: none"> - Tatimi në të ardhurat e korporatave - Tatimi mbi qiranë dhe pasurinë e patrupëzuar - Tatimi në të ardhurat individuale - Të ardhurat nga ortakëria - Pagesa për tatimin në të ardhurat personale për individë <p>Formularët përdoren për të siguruar që të gjitha detyrimet tatimore janë raportuar në mënyrë korrekte dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p>
Numri i deklarimeve	E paraqet numrin e herëve që një subjekt ka plotësuar dhe paraqitur formularë tatimor për t'i deklaruar obligimet tatimore ndaj ATK-së.	<p>Ky variabël ndihmon në monitorimin dhe analizën e shpeshtësisë së përdorimit të formularëve tatimor nga tatimpaguesit gjatë një periudhe të caktuar.</p> <p>Tatimpaguesi numërohet në dataset në secilin muaj në të cilin ai/ajo i ka raportuar përmes formularëve përkatës (pra, nëse tatimpaguesi ka deklaruar në janar, mars, korrik dhe shtator, ai/ajo do të jetë i/e numëruar 4 herë në atë dataset).</p>
Të punësuarit	Ky variabël e paraqet numrin e individëve që aktualisht janë në një marrëdhënie pune, duke i përfshirë këtu punëtorët me kohë të plotë, me kohë të pjesshme, dhe sezonal. Përfshihen të gjitha kategoritë e të punësuarve që kontribuojnë në ekonomi, pavarësisht nga sektori i punësimit ose nga natyra e marrëdhënies së tyre të punës.	
Vendet e punës	Ofron informacion mbi numrin e vendeve të punës, kategorinë e sektorit të industrisë, nivelin e pagave dhe gjininë e punëmarrësve.	I përfshin të gjitha format e organizatave që angazhojnë individë në marrëdhënie pune, pavarësisht nga modaliteti i punësimit - qoftë ai në një vendndodhje fizike, punë në distancë (remote), ose në një model hibrid. Vendet e punës mund të jenë nga të gjitha madhësitë dhe sektorët, duke i përfshirë këtu korporatat, bizneset e vogla, start-up-et, organizatat joqeveritare, dhe institucionet publike.
Numri total i të punësuarve të deklaruar	Ky variabël e tregon numrin e punonjësve të cilët janë raportuar nga tatimpaguesit në formularët tatimor. Ky numër i përfshin të gjithë individët që janë të regjistruar si të punësuar nga tatimpaguesi dhe që janë të lidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit.	Punonjësit e deklaruar janë të ndërlidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit i cili i ka deklaruar formularët e pagave, prandaj ata shfaqen si punonjës në qytetin ku tatimpaguesi është i regjistruar (për këtë arsye, punonjësit e tërë sektorit publik figurojnë në Prishtinë).

<p>Numri i të punësuarve primar</p>	<p>Numri i të punësuarve të deklaruar si të punësuar primar nga punëdhënësi përkatës. I punësuar e plotëson formularin për caktimin e punëdhënësit primar për të siguruar që obligimet tatimore të llogariten dhe të mbahen në mënyrën e duhur.</p>	<p>Punonjësit e deklaruar janë të ndërlidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit, prandaj ata shfaqen si punonjës në qytetin ku subjekti për të cilën ata punojnë është e regjistruar (për këtë arsye, punonjësit e tërë sektorit publik figurojnë në Prishtinë). Nëse një i punësuar deklaron më shumë se një punëdhënësi si primar, ai numërohet vetëm një herë në dataset si i punësuar primar.</p>
<p>Numri i të punësuarve sekondar</p>	<p>Numri i të punësuarve tek çfarëdo punëdhënësi tjetër përveç punëdhënësit primar, ku i punësuar mund të kryejë punë në mënyrë të pjesshme ose për një periudhë të caktuar kohore. Për të ardhurat nga punëdhënësi sekondar, mund të aplikohen rregulla të ndryshme tatimore, dhe i punësuar duhet të jetë i vetëdijshëm për të deklaruar dhe paguar çdo detyrim tatimor shtesë që mund të lind nga këto të ardhura.</p>	<p>Punonjësit e deklaruar janë të ndërlidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit, prandaj ata shfaqen si punonjës në qytetin ku subjekti për të cilën ata punojnë është e regjistruar. Nëse një i punësuar deklaron më shumë se një punëdhënësi si sekondar, ai numërohet vetëm një herë në dataset si i punësuar sekondar. Përfshin punonjës të cilët janë të marrë vetëm një herë si punëtorë sekondar. Kjo do të thotë që nëse një punonjës është konsideruar si punëtor sekondar edhe nga një kompani tjetër nuk do të numërohet më shumë se një herë në këtë kategori.</p>
<p>Meshkuj nga mosha 15 deri 24, 25 deri 34, 35 deri 44, 45 deri 54, 55 deri 64 si dhe 65+</p>	<p>Përdoret për individët e gjinisë mashkullore të regjistruar si punëmarrës në grupmoshat e caktuara, nga 15 deri në 24 vjet, 25 deri në 34 vjet, 35 deri në 44 vjet, 45 deri 54 vjet, 55 deri 64 vjet si dhe 65+ vjet.</p>	<p>Punonjësit e deklaruar janë të ndërlidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit, prandaj ata shfaqen si punonjës në qytetin ku subjekti për të cilën ata punojnë është e regjistruar.</p>
<p>Femra nga mosha 15 deri 24, 25 deri 34, 35 deri 44, 45 deri 54, 55 deri 64 si dhe 65+</p>	<p>Përdoret për individët e gjinisë femërore të regjistruar si punëmarrës në grupmoshat e caktuara, nga 15 deri në 24 vjet, 25 deri në 34 vjet, 35 deri në 44 vjet, 45 deri 54 vjet, 55 deri 64 vjet si dhe 65+ vjet.</p>	<p>Punonjësit e deklaruar janë të ndërlidhur me numrin fiskal të tatimpaguesit, prandaj ata shfaqen si punonjës në qytetin ku subjekti për të cilën ata punojnë është e regjistruar.</p>
<p>Paga</p>	<p>Ky variabël e përcakton shumën e parave që një punonjës e merr nga punëdhënësi si kompensim për punën e kryer.</p>	<p>Paga mund të jepet si kompensim për orët e punës, ditët e punës, ose mund të jetë një shumë fikse që paguhet në intervale të rregullta, si për shembull pagë mujore. Paga e përfshin rrogën bazë dhe çdo shtesë tjetër të ligjshme që mund të përfshihet në të, siç janë orët shtesë, bonuset (shtesat), kompensimi për pushimet, dhe përfitime të tjera monetare që mund të përcaktohen në kontratën e punës ose të rregullohen me ligj.</p>

		<p>Paga është subjekt i tatimit në të ardhura personale dhe kontributeve të tjera sipas legjislacionit në fuqi në Kosovë.</p> <p>Punëdhënësi është përgjegjës për t'i mbajtur dhe paguar këto tatime dhe kontribute në emër të punonjësit nëpërmjet sistemit të pagesave të tatimeve dhe kontributeve në burim.</p>
<p>Paga mesatare, paga mesatare për meshkuj, paga mesatare për femra</p>	<p>Përdoret për ta shprehur shumën mesatare të pagës për të punësuarit në grupin e tyre gjinor përkatës. Gjetet duke e ndarë shumën totale të të ardhurave të tyre, me numrin total të grupit gjinor.</p>	
<p>Tatimi/Tatimet</p>	<p>'Tatimi' ose 'Tatimet' i përcaktojnë detyrimet financiare të cilat tatimpaguesit (individët, bizneset, dhe subjektet e tjera) i kanë ndaj shtetit, që janë të përcaktuara me ligj dhe duhet të paguhet në kohë të caktuar.</p>	<p>Administrata Tatimore e Kosovës është organi përgjegjës për mbledhjen, administrimin dhe zbatimin e ligjeve tatimore.</p> <p>Tatimet mund të jenë të ndryshme në natyrë dhe përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në: Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH), Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, etj.</p>
<p>Pagesat e tatimeve sipas periudhës</p>	<p>I përfshin të dhënat mbi shumën e parave që një subjekt i ka paguar në formë tatimesh në një periudhë të caktuar kohore (mujore, tremujore, vjetore).</p>	<p>Pagesat e tatimeve që bëhen brenda një muaji specifik regjistrohen në datasetin për atë muaj.</p>
<p>Investimet</p>	<p>Janë veprime që e përfshijnë përdorimin e parave ose të burimeve financiare për të blerë shërbime/mallra/pasuri me qëllim të përfitimit në të ardhmen.</p>	
<p>Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH)</p>	<p>Tatimi që aplikohet mbi vlerën e shtuar të një malli ose shërbimi në një proces të shitjes ose furnizimit të tij.</p>	<p>Ky tatim paguhet nga konsumatorët, por mblidhet dhe raportohet nga subjektet e tatueshme, zakonisht subjekti që e ofrojnë mallin ose shërbimin.</p> <p>Norma e këtij tatimi përcaktohet me ligj. TVSH në disa raste mund të kreditohet ose zbritet, siç e përcakton legjislacioni në fuqi.</p>
<p>Blerjet vendore</p>	<p>Blerja e produkteve ose të shërbimeve që ndodhin brenda Kosovës.</p>	<p>Transaksionet e blerjes janë kryer mes palëve që janë të vendosura në Kosovë dhe produktet ose shërbimet janë prodhuar, ofruar ose janë në dispozicion brenda territorit të Kosovës.</p>
<p>Importi</p>	<p>Blerja e produkteve ose të shërbimeve nga jashtë vendit,</p>	<p>Në kontekst të Kosovës, 'Importi' do të thotë që mallrat ose shërbimet janë blerë nga subjekte që janë të vendosur jashtë kufijve të Kosovës dhe</p>

	pra nga një shtet ose territor tjetër.	janë transportuar brenda vendit. Importet përfshijnë një gamë të gjerë transaksionesh ndërkombëtare dhe janë pjesë e tregtisë së jashtme të një vendi.
Blerjet dhe importet investive pa TVSH	Shuma e blerjeve vendore dhe e importeve të cilat do të përdoren për investime dhe për të cilat nuk llogaritet TVSH. Me anë të Ligjit për TVSH-në përcaktohen investimet për të cilat nuk llogaritet TVSH.	Blerjet dhe importet investive pa TVSH janë indikatorë dinamik sipas periudhave.
Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme	Këtu është përfshirë shuma e blerjeve vendore apo e importeve për të cilat aplikohet TVSH, mirëpo tatimpaguesit nuk e kanë të drejtën e kreditimit të asaj TVSH-je si dhe të cilat do të përdoren për investime. Me anë të ligjit për TVSH përcaktohen të drejtat për kreditimin e TVSH-së.	Blerjet dhe importet investive me TVSH jo të zbritshme janë indikatorë dinamik sipas periudhave.
Importet investive me normë 18%	Ky variabël e përfshin totalin e importeve që janë bërë nga tatimpaguesit për qëllime investimi dhe për të cilat është aplikuar norma e TVSH-së prej 18%.	Në kontekstin e të dhënave të hapura, është thelbësore të kuptohet se shuma e paraqitur në këtë variabël e përfaqëson vetëm vlerën e tatueshme të importeve, pa e përfshirë shumën e vet TVSH-së.
Importet investive me normë 8%	Ky variabël e përfshin totalin e importeve që janë bërë nga tatimpaguesit për qëllime investimi dhe për të cilat është aplikuar një normë e TVSH-së prej 8%.	Ekziston një kategori e veçantë e importeve investive që gëzojnë një normë më të ulët të TVSH-së, e cila mund të jetë pjesë e një politike tatimore për t'i inkurajuar investimet në sektorë të caktuar ose për blerje të caktuara kapitale. Në datasetet e të dhënave të hapura, është e rëndësishme të kemi parasysh që vlera e paraqitur është vetëm vlera e tatueshme dhe këtu nuk përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).
Blerjet investive vendore me normë 18%	Këtu është përfshirë shuma e blerjeve investive vendore për të cilat është aplikuar TVSH me normë 18%, në bazë të ligjit për TVSH-në.	Në datasetet e të dhënave të hapura, është e rëndësishme të kemi parasysh që vlera e paraqitur është vetëm vlera e tatueshme dhe nuk përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).
Blerjet investive vendore me normë 8%	Këtu është përfshirë shuma e blerjeve investive vendore për të cilat është aplikuar TVSH me normë 8%, në bazë të ligjit për TVSH-në.	Në datasetet e të dhënave të hapura, është e rëndësishme të kemi parasysh që vlera e paraqitur është vetëm vlera e tatueshme dhe nuk përfshihet tatimi mbi vlerën e shtuar (TVSH).

Subjekti	Përdoret për të identifikuar një person ose subjekt të caktuar që është i detyruar t'i deklarojë të ardhurat dhe t'i paguajë tatimet.	Në kontekstin e tatimeve, 'subjekti' mund të jetë një person fizik, një person juridik, ose çdo subjekt tjetër që kryen aktivitete ekonomike që janë të tatueshme.
Regjistri i tatimpaguesve	Është një bazë e të dhënave ose listë zyrtare e subjekteve që janë të regjistruar në sistemin elektronik të Administratës Tatimore të Kosovës.	
Data e regjistrimit të subjekteve	E përfshin datën kur një subjekt është regjistruar zyrtarisht në sistemin e ATK-së.	
Numri i subjekteve të regjistruara	E paraqet numrin e subjekteve që janë të regjistruar zyrtarisht në sistemin e ATK-së. Ky numër tregon sa subjekte janë të regjistruara në një periudhë të caktuar kohore.	
Statusi në ATK	E paraqet numrin e tatimpaguesve aktiv dhe pasiv, të përcaktuar sipas Ligjit mbi Administratën Tatimore dhe Procedurat.	Statusi i subjekteve në Administratën Tatimore të Kosovës është indikator dinamik sipas periudhave. Të dhënat mund të pësojnë ndryshime sipas Ligjit në fuqi në periudhën përkatëse për Administratën Tatimore dhe Procedurat. Këto ndryshime do të reflektohen vetëm për 3 vitet e fundit, ndërsa për vitet paraprake dosjet do të ruhen si të dhëna historike pas përfundimit të vitit përkatës.

Kodet NACE

Variabli 'Përshkrimi i Sektorit (Kryesor)' përmban një total prej 22 kodeve NACE, si më poshtë:

- Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm (O),
- Akomodimi dhe shërbimi ushqimor (I),
- Aktivitetet e ekonomive familjare si punëdhënës; Mallrat dhe shërbimet e pa diferencuara (T),
- Aktivitetet e ekonomive familjare për përdorim vetanak,
- Aktivitetet e patundshmërisë (L); Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale (Q),
- Aktivitetet e tjera shërbyese (S),
- Aktivitetet financiare dhe të sigurimit (K),
- Aktivitetet profesionale, shkencore dhe teknike (M),
- Arsimi (P),
- Artet, Argëtimi dhe rekreacioni (R),
- Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi (A),
- Furnizimi me rrymë, gaz, avull dhe ajër të kondicionuar (D),
- Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave (E),
- Industria nxjerrëse (B),
- Industria përpunuese (C),
- Informimi dhe komunikimi (J),
- Mungon aktiviteti,

- Ndërtimtaria (F),
- Person Fizik,
- Shërbimet administrative dhe mbështetëse (N),
- Transporti dhe magazinimi (H),
- Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave (G).

Informata më të hollësishme mund të gjenden në: <https://nacev2.com/en>

Deklaratat Tatimore

CD – Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pageses për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave

QL – Pasqyra Tremujore e Pagesës Paradhënie për Korporatat e Mëdha

QS – Pasqyra Tremujore e Pagesës së Tatimit për Korporatat e Vogla

DI – Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pagesës për Tatimin në të Ardhurat Personale për Individ

IL – Pasqyra tremujore e Tatimit dhe Kontributeve për bizneset e mëdha individuale

IR – Pasqyra e Tatimit mbi Qiranë dhe Pasurinë e Patrupëzuar

IS – Pasqyra Tremujore e Tatimit dhe Kontributeve për Bizneset e Vogla Individuale

PD – Formulari i Deklarimit Vjetor dhe Pageses për Tatimin në të Ardhurat Personale

TV – Formulari i Deklarimit dhe Pagesës së TVSH-së

WM – Pasqyra e Mbajtjes në Burim dhe Pagimit të Tatimit

WR – Pasqyra Mujore e Mbajtjes në Burim dhe Pagesës së Tatimit në Interes, të Drejta Pronësore, Qira, Fitore në Lotari dhe Lojra të Fatit dhe Personin jo-Rezident

Legjislacioni Tatimor në Fuqi

Ligji për Administrimin e Procedurave Tatimore: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=85269>

Ligji për Tatimin në të Ardhura Personale: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11014>

Ligji për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11016>

Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar (TVSH): <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11015>

Vegëza për Informata të Përgjithshme për Tatimet në Kosovë:

<https://www.atk-ks.org/portfolio/informata-te-pergjithshme-per-tatimet-ne-kosove/>

Përditësimi i të Dhënave

Përditësimi i të dhënave në një bazë të rregullt tremujore do të ndihmojë në krijimin e raporteve të rregullta dhe të besueshme për përdoruesit e ndryshëm. Duke i përditësuar të dhënat në bazë tremujore, përdoruesit sigurohen që informacioni është i kohës së fundit dhe i përdorshëm, dhe kjo ndihmon në parandalimin e përdorimit të të dhënave të vjetra. Përmbledhja e datave të përditësimit sipas datave është si më poshtë: a) **Tremujori i Parë** (Janar, Shkurt, Mars) përditësimi bëhet më datë **30 Prill**, b) **Tremujori i Dytë** (Prill, Maj, Qershor) përditësimi bëhet më datë **30 Korrik**, c) **Tremujori i Tretë** (Korrik, Gusht, Shtator) përditësimi bëhet më datë **30 Tetor**, d) **Tremujori i Katërt** (Tetor, Nëntor, Dhjetor) përditësimi bëhet më datë **30 Janar**. **Për vitin aktual dhe 2 vitet e fundit** përditësimi bëhet më datë **5 Maj** të vitit vijues.

Periudha e të dhënave	Data e procesimit	Data e publikimit në faqen e internetit
Janar, Shkurt, Mars	25 Prill	30 Prill
Prill, Maj, Qershor	25 Korrik	30 Korrik
Korrik, Gusht, Shtator	25 Tetor	30 Tetor
Tetor, Nëntor, Dhjetor	25 Janar	30 Janar
Ri-prodhimi dhe ri-ngarkimi i vitit të plotë të përfunduar (t)	30 Prill	5 Maj